

UDHËZIM
Nr. 5, datë 7.10.2019

**PËR MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E XHAMAVE TË ERRËSUAR ME
MATERIALE TË FABRIKUARA DHE TË HOMOLOGUARA NGA PRODHUESI,
PËR PËRDORIMIN E TYRE NË AUTOVETURA**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 72 dhe 75, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 224 dhe 230, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, direktivës 2007/46/KE, datë 5.9.2007, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Për miratimin e mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, dhe të sistemeve përbërëse dhe njësisive të veçanta teknike të destinuar për këto mjete”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

UDHËZON:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është organi i miratimit dhe i certifikimit të xhamave të errësuar me materiale të fabrikuar dhe të homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor miraton dhe certifikon xhamat e errësuar me materiale të fabrikuar dhe të homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura, në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe direktivës 2007/46/KE, datë 5.9.2007 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor harton dhe miraton Rregulloren e brendshme për gjithë procedurat administrative dhe teknike për miratimin dhe certifikimin e xhamave të errësuar me materiale të fabrikuar dhe të homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura.

4. Çdo xham i homologuar që vishet me material të homologuar duhet të miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Xham i errët do të konsiderohet xhami i veshur me material të homologuar që ka tejçueshmëri drite më pak se 70%.

5. Nuk lejohet errësimi i xhamit të përparmë ballor në autovetura. Përjashtimisht, lejohet ulja e tejçueshmërisë së dritës në xhamin e përparmë ballor vetëm në pjesën e sipërme, në një shirit gjatësor, gjerësia e të cilit është deri në 125 mm.

6. Rregullorja e brendshme për procedurat administrative dhe teknike për miratimin dhe certifikimin e xhamave të errësuar me materiale të fabrikuar dhe të homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura, lidhur me dokumentacionin që duhet paraqitur për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, duhet të parashikojë që të përmbajë, sipas rastit, edhe:

- a) dokumentin e origjinës nga prodhuesi;
- b) dokumentin e homologimit të materialeve për errësimin e xhamave nga institucioni kompetent përkatës, ose deklaratën e përputhshmërisë nga prodhuesi;
- c) shënimin përkatës në dokumentin me treguesit teknikë të mjetit, ose dokument tjetër me shënimin përkatës nga vendi i origjinës së mjetit;
- d) dokumentacionin nga subjekti që ka kryer errësimin e xhamave në autoveturë, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;
- e) garancinë për punimet e kryera për errësimin e xhamave.

7. Subjektet që errësojnë xhamat, në zbatim të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, duhet të disponojnë licensë për kategorinë VII.3.B.1/b.

8. Subjektet që do të kryejnë errësimin e xhamave, duhet të lëshojnë garancinë për punimet e kryera.

9. Vlefshmëria e certifikatës së miratimit do të jetë e njëjtë me afatin e garancisë të lëshuar nga subjekti i licensuar që ka kryer errësimin e xhamave.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pasi të miratojë errësimin e xhamave, do të lëshojë certifikatën përkatëse, sipas modelit të miratuar, për xhama të errësuar me materiale të fabrikua dhe të homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura, e cila duhet mbajtur gjithmonë në autoveturë.

11. Organet e përcaktuara për të kryer kontrollin teknik të autoveturave, nuk duhet të kryejnë kontrollin teknik të autoveturave me xhama të errësuar të pa miratuar e certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor informon periodikisht Drejtorinë e Policisë Rrugore për mjetet të cilat kanë miratuar e certifikuar xhamat e errësuar me materiale të fabrikua dhe homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura.

13. Pronarët e mjeteve të interesuar për miratimin dhe certifikimin e xhamave të errësuar me materiale të fabrikua dhe homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura, duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të kryer procedurat e nevojshme, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e udhëzimit.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të organizojë punën duke siguruar materialet dhe pajisjet e nevojshme që miratimi e certifikimi i xhamave të errësuar me materiale të fabrikua dhe të homologuara nga prodhuesi, për përdorimin e tyre në autovetura, të fillojë brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e udhëzimit.

15. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të propozojë tarifën përkatëse për miratim, për këtë shërbim, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e udhëzimit.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet drejtoria përkatëse në ministri dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku